

# ADING BETOKONTAKT

Nënshtresë (bazë) për llaçe dhe ngjitës

## FUSHA E APLIKIMIT

Ading Betokontakt është një nënshtresë(primer) dhe stabilizues i nënshtresave për sipërfaqe të dobëta poroze dhe të lëmuara, për të përmirësuar dhe barazuar porozitetin e sipërfaqeve të betonit, për të siguruar vrazhdësi të sipërfaqeve të lëmuara, si dhe për të arritur një lidhje më të mirë midis nënshtresës bazike dhe shtresës së re. Përdoret para suvatimit me llaç klasik ose mekanik, të gipsit, çimentos ose llaç të zgjatur ose gjatë ngjitjes me ngjitës në bazë çimentoje.

## CILËSI

- Material një-komponentësh mbi bazë polimeri ujëdisperziv(ujëshpërndarës)
- I përkueshëm nga avulli
- Ofron vrazhdësi të nënshtresës
- I tretshëm në ujë
- Mundëson aplikim të vonuar(zgjatur) të shtresës tjetër
- Realizim i thjeshtë

## KARAKTERISTIKA TEKNIKE

Dendësia	EN ISO 2811-1	1,6-1,7g/cm <sup>3</sup>
Sasia e mbushjes	-	0,25mm
pH	-	7-9
Koha e tharjes në 20°C në lagështi relative të ajrit prej 50-60%	-	4h

## METODOLOGJIA E REALIZIMIT

### PËRGATITJA E NËNSHTRESËS

Nënshtresa duhet të jetë e shëndoshë, e fortë, e thatë, e pastër, pa yndyrë, pa pluhur dhe pa pjesë të paqëndrueshme. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit duhet të jetë ndërmjet +5°C dhe +35°C, me një lagështi relative të ajrit prej 50-60%. Sipërfaqet që përpunohen në momentin e futjes në përdorim nuk duhet të ekspozohen drejtpërdrejt nga rrezet e diellit dhe shiut.

### PËRGATITJA E MATERIALIT

Materiali përgatitet duke e holluar deri në 20% me ujë, pas së cilës përzihet derisa të jetë plotësisht i njëtrajtshëm. Raporti i rekomanduar i përzierjes Ading Betokontakt: ujë = 5:1.

### APLIKIMI

Aplikimi kryhet me një furçë ose rul në një shtresë. Nuk lejohet aplikimi nën ekspozim të drejtpërdrejtë të rrezeve të diellit dhe shiut. Hedhja e shtresës tjetër (materiali i ri: llaç, ngjitës) në sipërfaqen e

shtypur(prajmeruar) kryhet në një shtresë të tharë më parë me Ading Betokontakt. Intervali kohor ndërmjet shtresave, në temperaturën 20°C, me lagështi relative të ajrit 50-60%, është 4 orë. Sipërfaqet e trajtuara duhet të mbrohen nga rrezet direkte të diellit, era e fortë, ngrica dhe pluhuri për një periudhë prej 4 orësh pas aplikimit, si dhe nga shiu dhe kontakti me ujën deri në momentin e aplikimit të materialit tjetër në sipërfaqen e

Faqe 1 nga 2

shtruar. Temperatura e nënshtresës dhe e ajrit gjatë aplikimit duhet të jetë nga 5°C deri në 35°C. Lagështia e lartë e ajrit dhe temperaturat e ulëta gjatë aplikimit mund të zgjasin ndjeshëm kohën e lidhjes.

Vërejtje: Shpenzimi i përshkruar i materialit, gjatë aplikimit me spërkatje, mund të rritet, në varësi të kushteve gjatë aplikimit.

## **SHPENZIMI**

0,15-0,25kg/m<sup>2</sup>

## **PASTRIMI**

Veglat dhe pajisjet pastrohen me ujë menjëherë pas përdorimit.

## **PAKETIMI**

Në kova plastike prej 4 dhe 20kg

## **VENDOSJA NË DEPO**

Në paketim origjinal, të mbyllur, në temperaturë 5°C deri në 35°C, të mbrojtur nga rrezet direkte të diellit Afati i përdorimit: 12 muaj

Rreziku për shëndetin: Është e nevojshme të shmangni kontaktin e produktit me lëkurën (përdorni dorëza mbrojtëse). Materiali nuk është toksik, por në rast kontakti aksidental, në rast kontaminimi të sipërfaqeve të lëkurës, ato pjesë duhet të lahen menjëherë me sapun dhe ujë. Nëse materiali spërkat në sy, është e nevojshme që menjëherë të shpëlahet me ujë të bollshëm dhe të kërkoni ndihmë mjekësore.

Zjarri: Ading Betokontakt nuk është testuar për reagim ndaj zjarrit

Pastrimi dhe magazinimi: Pastrimi i mbetjeve të shpërndara të Ading Betokontakt-it bëhet me ujë. Paketimi i vjetër i përdorur duhet të hidhet sipas rregulloreve lokale për atë lloj mbeturinash.

Rekomandojmë që mënyra e aplikimit dhe sasi të nevojshme të përshtaten me kushtet e objektit, si dhe përdorimin e domosdoshëm të pajisjeve përkatëse.